

gusht 2011

gap

monitor

i vendimeve të Qeverisë së Kosovës

**Qeveria aprovon Projektligjin për
Qeverinë dhe Rregulloren e re të Punës**

- Plotësohet Ligji për Financimin e Partive Politike

- Miratohet projektligji i fundit nga Pakoja e Ahtisaarit



Hyrje

Gjatë muajit gusht 2011, Qeveria e Kosovës ka mbajtur shtatë mbledhje të rregullta. Njëra nga to, mbledhja e 31-të, ishte e karakterit informues për gjendjen e krijuar pas marrëveshjes me KFOR-in për shpalljen e pikave kufitare 1 dhe 31 si zona të kufizuara ushtarake. Në gjashtë mbledhjet tjera, janë marrë gjithsejt 36 vendime të karakterit të ndryshëm.

Në muajin gusht, Qeveria ka miratuar 14 projektligje. Në periudhën janar-gusht 2011, Qeveria ka miratuar 72 projektligje, apo 48% e Startegjisë Legjislative 2011. Deri në fund të vitit kanë mbetur edhe katër muaj, kurse janë edhe 78 projektligje në SL'2011 që pritet të miratohen brenda vitit. Shumica e projektligjeve të miratuara deri më tani, nuk janë miratuar sipas afatit të përcaktuar me strategjinë legjislative.

Në mesin e 14 projektligjeve të miratuara në Qeveri gjatë muajit gusht është edhe Projektligji për Qeverinë. Ky projektligj i është dërguar Kuvendit për herë të dytë që nga viti 2009. Mirëpo, projektligji është i mangët për nga përmbajtja dhe nuk ofron asgjë më tepër se ajo që është e paraparë me Kushtetutë, Rregullore të Punës së Qeverisë, dhe akte tjera nënligjore. Instituti GAP ka dhënë rekomandimet konkrete se çfarë duhet të përmbaj një ligj për degën ekzekutive të qeverisjes. E një nga rekomandimet e dhëna, që nuk parashihet me draftin aktua të këtij ligji, është edhe e drejta e Kuvendit për të vendosur për numrin e portofolave ministrore. (raportin për përmbajtjen e Projektligjit të Qeverisë dhe Rregullorës së Punës së Qeverisë mund ta lexoni në brendi të GAP Monitor).

Projektligj tjetër i rëndësishëm i miratuar gjatë këtij muaji është edhe Projektligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Financimin e Subjeteve Politike. Projektligji në fjalë është miratuar me qëllim ngritjen e nivelit të transparencës së financimit të subjekteve politike. Për dallim nga ligji aktual, tani pasqyrat financiare të partive politike do t'i auditoj Zyra e Auditorit të Përgjithshëm.

Prej vendime të tjera që konsiderohen të rëndësishme, Qeveria e Kosovës ka miratuar edhe Planin Zhvillimor Strategjik 2011 - 2013 të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim, Strategjinë e Arsimit 2011 – 2015, Programin e Kosovës kundër Dhunës në Familje dhe Planin e Veprimit 2011 – 2014 si dhe Stragjinë për Shëndetin e Nënës, Fëmijës, Adoleshentit dhe Shëndetin Riprodhues. (raportet për këto dokumente mund t'i lexoni në vazhdim).

Raportet individuale për të gjitha vendimet e marra gjatë muajit gusht 2011 mund t'i gjeni edhe në portalin e GAP Monitor në internet www.institutigap.org

Përmbajtja

Qeveria aprovon Projektligjin për Qeverinë dhe Rregulloren e re të Punës	4
Miratohen edhe 14 projektligje	7
Ndryshohet/plotësohet Ligji për Financimin e Partive Politike	9
Komisioni Evropian nuk i jep më rroga Agjencionit Kosovar të Privatizimit	10
Qeveria vazhdon me shpronësim të pronave të paluajtshme për Autostradën Vërmicë – Merdare	11
Miratohet Plani Zhvillimor Strategjik 2011-2013 i Ministrisë për Komunitete e Kthim	12
Themelohet Bordi për Hartimin dhe Monitorimin e Strategjisë për Ri-integrimin e Personave të Riatdhesuar	12
Miratohet edhe projektligji i fundit nga Pakoja e Ahtisaarit	14
Definohet kufiri ndarës i aseteve në mes të KEK-ut dhe KOSST-it	16
Përcaktohet paga minimale në Republikën e Kosovës	17
Ministria e Infrastrukturës kompenzon mjetet financiare për shërbimet e transportit humanitar për banorët e Kodrës së Minatorëve në Mitrovicë	17
PTK ndan edhe 15 milionë euro për buxhet	17
Miratohet Plani Strategjik për Arsimin e Kosovës 2011-2016	18
Blog Ndërmarrësia dhe profesionet e së ardhmes në Kosovë	20
PËRMBLEDHJE E VENDIMEVE TË GUSHTIT 2011	22



Më në fund, Qeveria aprovon Projektligjin për Qeverinë dhe Rregulloren e re të Punës

Në mbledhjen e 33 të Qeverisë së Kosovës, mbajtur më 17 gusht 2011, me vendimin 02/33 u miratua Projektligji për Qeverinë e Republikës së Kosovës. Funksonet e Qeverisë së Kosovës apo degës ekzekutive të qeverisjes që nga viti 2011 janë të rregulluara me rregullore të UNMIK. Që nga viti 2008, Qeveria e Kosovës ka filluar përgatitjet për hartimin e Projektligjit për Qeverinë. Në prill të 2009, Qeveria aprovoi për herë të parë Projektligjin për Qeverinë.

Mirëpo, Kuvendi i Kosovës kishte refuzuar këtë projektligj me arsyetimin se projektligji nuk përmban Vlerësimin e Ndikimit Financiar. Që nga ajo kohë, e deri në gusht 2011, Qeveria nuk e miratoi Projektligjin për Qeverinë, duke vazhduar që të funksionoj me Rregulloren e UNMIK-ut 2001/19 për degën ekzekutive

të Institucioneve Vetëqeverisëse.

Projektligji i Qeverisë i miratuar në gusht të 2011 përcakton organizimin dhe funksionimin e Qeverisë, mënyrën e punës dhe procedurat e vendimmarrjes, bashkëpunimin e Qeverisë me institucionet tjera të përcaktuara në Kushtetutë.

Sipas nenit 3 të projektligjit,

Qeveria nuk ka dërguar në Kuvend një vlerësim të plotë të ndikimit buxhetor për Ligjin për Qeverinë, por ka përlogaritur vetëm koston shtesë pas hyrjes së ligjit në fuqi

Qeveria përbëhet nga Kryeministri, një apo më shumë zëvendëskryeministra, ministrat dhe deri në dy ministra pa portofol. Askund në tekstin e projektligjit nuk ceket numri i saktë i zëvendëskryeministrave dhe ministrave, ashtu siq ishte e rregulluar me Rregullorën e UNMIK-ut 2001/19. Kjo lë

mundësinë që për numrin e portofolave ministrore të vendos Kryeministri, pa marrë aprovimin e Kuvendit të Kosovës.

Qështje tjetër me rëndësi e cila pritet të rregullohet me Ligjin për Qeverinë është edhe funksionet dhe kompetencat e qeverisë në largim. Deri më tani, aktet ligjore në fuqi nuk

kanë paraparë funksionet e një qeverie në largim apo qeverie në dorëheqje. Në mungesë të kësaj baze ligjore, pas shpalljes së zgjedhjeve të jashtëzakonshme dhe pas mocionit të mosbesimit në Kuvendin e Kosovës në nëntor të 2010, Qeveria e Kosovës funksionoi si qeveri në dorëheqje për reth katër muaj. Gjatë kësaj



kohe qeveria në largim mori disa vendime ekzekutive, ndër to edhe vendimin për rritjen e pagave të punonjësve në sektorin publik, të cilat pastaj ndikuan në tërë qeverisjen e vitit 2011. Sipas nenit 8, pika 5 të Projektligjit për Qeverinë, qeveria në largim kryen vetëm punët e rregullta dhe nuk mund t'i paraqesë Kuvendit

afariste ose të informacioneve të klasifikuara të sigurisë.

Neni 27 shtjellon bashkëpunimin e Qeverisë me Kuvendin. Në praktikën e gjertanishme të qeverisjes, anëtarët e Qeverisë nuk u janë përgjigjur rregullisht kërkesave për takim në komisione parlamentare apo nuk kanë qenë prezent në

Kryeministri/ja mund të emërojë deri në 12 këshilltarë politik, zv.kryeministrat deri në gjashtë këshilltarë politik, ministrat deri në gjashtë këshilltarë politik, ministrat pa portofol deri në dy këshilltarë politik. Kompetencat e këshilltarëve politik dhe kodi i mirësjelljes së tyre, do të përcaktohen me një rregullore, e cila miratohet nga Qeveria pas propozimit nga Kryeministri.

Pas hyrjes në fuqi të Ligjit për Qeverinë e Kosovës, shfuqizohet Rregullorja e UNMIK 2001/19 dhe të gjitha rregulloret për plotësimin dhe ndryshimin e saj. Mirëpo, deri në plotësimin e bazës ligjore me akte nënligjore, do të vazhdojnë të zbatohen edhe më tutje urdhëresat administrative të UNMIK-ut për zbatimin e Rregullores së UNMIK 2001/19.

Në qershor të këtij viti, Instituti GAP ka publikuar analizën "Një ligj për Qeverinë" në të cilën kemi argumentuar nevojën e miratimit të këtij ligji,

Për dallim nga Rregullorja e UNMIK 2001/19 për degën ekzekutive, e cila mbetet në fuqi deri në hyrjen në fuqi të Ligjit për Qeverinë, drafti aktual i Ligjit për Qeverinë nuk cek numrin e posteve ministrore

projektligje apo të nxjerrë akte të përgjithshme përveç nëse kjo është e lidhur me ndonjë afat ligjor apo kërkesat e shtetit në interes të mbrojtjes apo në rastet e fatkeqësive natyrore apo gjendjes së jashtëzakonshme.

Sipas nenit 24 pika 2, Dokumentet e Qeverisë, janë publike, me përjashtim të informacioneve që janë të kufizuara me ligj, për shkak të privatësisë, të sekreteve

seancat e Kuvendit kur iu janë parashtruar pyetje parlamentare. Sipas pikës 5 të nenit 27 të Projektligjit për Qeverinë, ministrat/et duhet të marrin pjesë në seancat e Kuvendit dhe në mbledhjet e komisioneve punuese të tij në shqyrtimin e materialeve, të cilat Qeveria ia ka dërguar Kuvendit, dhe të materialeve nga propozues të tjerë, si dhe shqyrtimin e nismave dhe pyetjeve parlamentare.

duke dhënë rekomandime konkrete për përmbajtjen kryesore të tij. Disa nga rekomandimet e paraqitura në këtë analizë janë edhe se Ligji për Qeverinë duhet ti jap të drejtën Kuvendit për të themeluar dhe shuar postet ministore; Ligji për Qeverinë duhet të plotësoj zbrastirën ligjore sa i përket funksioneve dhe kompetencave të qeverisë në dorëheqje dhe qeverisë në largim; Ligji për Qeverinë duhet t'i obligojë anëtarët e kabinetit qeveritar që t'i përgjigjen pyetjeve të deputetëve në seanca plenare dhe thirrjeve për të raportuar në

dhe nuk lejohet publikimi i tyre. Kjo është në kontradiktë me nenin 71 të të njëjtës rregullore, sipas së cilit, “mbledhjet e qeverisë do të jenë publike, përveç nëse Qeveria vendos të mbajë një mbledhje të plotë ose një pjesë të një mbledhje me dyer të mbyllura; mbledhjet publike të Qeverisë do të jenë të hapura për gazetarët dhe përfaqësuesit tjerë të opinionit publik.” Në rast se mediat dhe publiku i gjerë mund të përcjellin mbledhjet e Qeverisë, nuk ka asnjë arsyeja që procesverbalet të mbahen strikt konfidenciale.

Rregullorja e re e Punës së Qeverisë parasheh mekanizma më të mirë për të siguruar konsistencën e Qeverisë me planet vjetore të punës, stabilitetin financiar, integritet evropiane, legjislacionin në fuqi, etj. Kjo është shumë e domosdoshme pasi që në të kaluarën ka ndodhur që të merren vendime pa u përlllogaritur mirë ndikimi financiar, përputhshmëria me parimet e përbashkëta të BE, etj.

Rregullorja themelon edhe Këshillin e Sekretarëve të Përgjithshëm. Këshilli përbëhet nga Sekretari dhe Sekretarët e Përgjithshëm të të gjitha ministrive, si dhe nga Drejtorët e Zyrës Ligjore, Sekretariatit dhe Zyrës për Planifikim Strategjik.

Rregullorja e re e Punës së Qeverisë parasheh shqyrtimin e amendamenteve për projektligjet para se ato të miratohen përfundimisht në Kuvend. Sipas nenit 62 të Rregullores, nëse propozohet amendament në ligjin, rregulloren apo aktin e përgjithshëm, Sekretariati ia dërgon amendamentin e propozuar ministrisë përgjegjëse dhe cakton afatin kohor për formulimin e një mendimi për shqyrtim në Qeveri. Nëse propozohen disa amendamente, ministria formulon mendimin për këto amendamente. Mirëpo, mbetet e paqartë se si Sekretaria e ZKM informohet për amendamentet e komisioneve

Rregullorja e Punës së Qeverisë e miratuar në muajin gusht 2011 është më e avancuar se Rregullorja e Punës së Qeverisë nr.01/2007, mirëpo edhe më tutje, Qeveria i klasifikon procesverbalet e mbledhjeve të Qeverisë si dokumente strikt konfidenciale

komisionet parlamentare; Pas miratimit të Ligjit për Qeverinë, Qeveria duhet ta ndryshojë Rregulloren e saj të Punës dhe ta përshtat atë me Ligjin për Qeverinë dhe Ligjin për Qasje në Dokumente Publike, etj.

Po në muajin gusht, në mbledhjen e 34 të Qeverisë së Kosovës, me vendimin 05/34, Qeveria ka aprovuar edhe Rregulloren e re të Punës së Qeverisë së Kosovës. Instituti GAP disa herë ka kërkuar miratimin e një rregulloreje të re të punës për Qeverinë, me qëllim që rregullorja të përshtatet me Ligjin për Qasje në Dokumente Publike dhe të lejoj shoqërinë civile të monitoroj punën e Qeverisë.

Mirëpo, vërejtjet e GAP nuk janë marrë parasysh gjatë hartimit të Rregullores së punës së Qeverisë. Edhe me rregulloren e re, procesverbalet e Qeverisë klasifikohen strikt konfidenciale

Një nga pikat që vlen të potencohen në këtë rregullore, është edhe organizimi i konsultimeve publike. Në bazë të pikës 1 të nenit 32, “gjatë përgatitjes së propozimeve për të cilat kërkohet koncept dokumenti, përveç konsultimit të ministrive dhe organeve të tjera të administratës publike, organi propozues duhet të publikojë përmbajtjen e propozimit të saj për komente nga publiku dhe në mënyrë specifike do të kërkojë komente nga organizatat

Rregullorja e Qeverisë obligon organet qeveritare që para aprovimit të politikave publike të hapin diskutimet me organizatat e shoqërisë civile

joqeveritare të cilat ndikohen në mënyrë të konsiderueshme nga propozimi.” Ky është një hap i madh përpara, ngase në praktiken e gjertanishme, Qeveria e Kosovës në të shumtën e rasteve ka mbajtur të mbyllur procesin e hartimit të politikave.

parlamentare të Kuvendit.

Në përgjithësi, Rregullorja e re e Qeverisë është më e avancuar se Rregullorja nr.01/2007. Përderisa Projektligji për Qeverinë kërkon amendamentim shtesë në Kuvend.



Miratohen edhe 14 projektligje

Nëse synohet përmbushja e Strategjisë Legjislative 2011, Qeveria duhet të miratoj edhe 78 projektligje në katër muajt në vazhdim

Gjatë muajit gusht, Qeveria e Kosovës ka miratuar 14 projektligje nga Strategjia Legjislative 2011. Me këto 14 projektligje, numri i projektligjeve të miratuara në shtatë mujorin e parë të 2011 ka arritur në 72. Strategjia Legjislative e 2011 përmban 150 projektligje. Në katër muajt e mbetur, Qeverisë

i duhet të miratoj edhe 78 projektligje për të përmbushur Strategjinë Legjislative.

Tabela më poshtë pasqyron 14 projektligjet e miratuara në gusht, datat e miratimit të tyre në Qeveri, afatet kohore të parapara me SL'11 dhe afatet kohore të parapara me Planin e Punës së Kuvendit të Kosovës për 2011.

Projektligji për:	Dërgimi në ZSHNJ ashtu siç parashihet me SL'11	Miratimi në Qeveri	Plani i Punës së Kuvendit të Kosovës 2011	
			Leximi i I	Leximi i II
Agjencinë Kosovare të Forenzikës	15.7.2011	2.8.2011	9/2011	11/2011
Ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për financimin e Subjekteve Politike	30.9.2011	3.8.2011	10/2011	12/2011
Ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Shtetësinë e Kosovës	30.6.2011	3.8.2011	7/2011	10/2011
Të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta	31.5.2011	3.8.2011	7/2011	9/2011
Projektligji për Mbeturina	31.5.2011	3.8.2011	6/2011	9/2011
Projektligji për Hekurudhat	30.5.2011	3.8.2011	7/2011	9/2011
Projektligji për Shitjen e Banesave për të cilat Ekziston e Drejta Banesore	30.6.2011	10.8.2011	7/2011	10/2011
Projektligji për Policinë	30.7.2011	10.8.2011	9/2011	11/2011
Projektligji për fshatin Hoçë e Madhe	30.4.2011	10.8.2011	5/2011	7/2011
Projektligji për Qeverinë e Republikës së Kosovës	31.5.2011	17.8.2011	7/2011	9/2011
Projektligji për Agjencinë e Kosovës Mbrojtjen nga Rrezatimi dhe Siguria Bërthamore	30.7.2011	17.8.2011	9/2011	11/2011
Projektligji për të Huajt	1.10.2011	25.8.2011	10/11	12/2011
Projektligji për Shërbime Këshilluese për Bujqësi dhe Zhvillim Rural	31.3.2011	25.8.2011	4/2011	6/2011
Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2003/24 për Sport	30.4.2011	25.8.2011	5/2011	7/2011

Gjatë muajit gusht, Qeveria e Kosovës ka miratuar 14 projektligje nga Strategjia Legjislative 2011. Me këto 14 projektligje, numri i projektligjeve të miratuara në shtatë mujorin e parë të 2011 ka arritur në 72. Strategjia Legjislative e 2011 përmban 150 projektligje. Në katër muajt e mbetur, Qeverisë i duhet të miratoj edhe 78 projektligje për të përmbushur Strategjinë Legjislative.

Tabela më poshtë pasqyron 14 projektligjet e miratuara në gusht, datat e miratimit të tyre në Qeveri, afatet kohore të parapara me SL'11 dhe afatet kohore të parapara me Planin e Punës së Kuvendit të Kosovës për 2011.

Projektligjet që i janë shtuar SL'11 janë:

- Projektligji për Parkun Kombëtar "Sharri",
- Projektligji për Parkun Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna",
- Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-168 për Turizmin dhe Shërbimet Turistike;
- Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.2004/28 për Punimet nga Metalet e Çmuara,
- Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.2004/5 për Tregtinë me Naftë dhe Derivate të Naftës si dhe
- Projektligji për Pengun.

Ndërsa projektligjet të cilat janë larguar nga SL'11 janë:

- Projektligji për Organizimin dhe Funkcionimin e Shërbimeve Publike të Punësimit në Kosovë;
- Projektligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 2001/42 për Veprimtarinë Kërkimore-Shkencore;
- Projektligji për Parqet Nacionale si dhe
- Projektligji për Organet Qeveritare për Shoqërinë e Informacionit.

Deri më tani numri i projektligjeve të miratuara në periudhën mars – gusht 2011 ka arritur në 72 apo 48% e SL'11 është përmbushur.



Ndryshohet/plotësohet Ligji për Financimin e Partive Politike

Në mbledhjen e 29 të Qeverisë së Kosovës, e cila u mbajt më 3 gusht 2011, u miratua Projektligji për ndryshimin/plotësimin e Ligjit për Financimin e Partive Politike.

Arsyetimi që është dhënë për plotësim/ndryshimin e këtij ligji

raporteve financiare të partive politike është KQZ. Neni 15 i cili specifikon procedurat e raportimit financiar parasheh që subjektet politike t'i dorëzojnë për çdo vit raportin vjetor financiar më së largu deri më 1 mars të vitit vijues në mënyrën e paraparë

ashpra. Duke e marrë parasysh faktin që me marrëveshjen politike të arritur në mes të PDK, LDK dhe AKR për ndryshimet kushtetuese ku ndër tjera i pari i vendit parashihet të zgjidhet drejtëpërdrejtë nga populli, kandidati/ja për president poashtu futet në dispozitë ligjore i/e cili/a në rast të shkeljes së dispozitave ligjore mund të gjobitet nga 5,000 deri në 50,000 euro. Në ligjin aktual që është në fuqi, kjo masë ndëshkimore ishte 3,000 deri në 10,000 euro. Ndërkaq, për kandidatët për deputet, kryetar komune, këshilltar si dhe kandidatët e pavarur, gjobat që ishin paraparë më herët silleshin nga 500 deri në 3,000 euro për dallim me projektligjin e ri ku masat ndëshkimore shkojnë nga 1,000 deri në 5,000 euro.

Ligji për Themelimin e Zyrës

Kompetencat për ushtrimin e kontrollit të të raporteve financiare të partive politike dhe KQZ-në tani kalojnë në duar të Auditorit të Përgjithshëm

është niveli i ulët i transparencës nga subjektet politike për prejardhjen e financimit të tyre, të ndërrohen përgjegjësitë e institucionit të KQZ-së me atë të Auditorit të Përgjithshëm. Mirëpo, partitë në pushtet të cilat kanë shtyrë përpara ndryshim/plotësimet, vetë ato nuk i kanë bërë publike financat e partive të tyre. Me ligjin aktual në fuqi parashihet që institucioni përgjegjës për kontrollin e

nga KQZ-ja.

Ndërkaq, me projektligjin e ri parashihet që kjo përgjegjësi tashmë t'i kalohet Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm i cili do të ketë përgjegjësinë e ngritjes së nivelit të transparencës së partive politike rreth mënyrave dhe burimit të financimit të tyre duke përfshirë këtu edhe institucionin e KQZ-së.

Gjithashtu, masat ndëshkimore pritet të jenë më të

së Auditorit të Përgjithshëm dhe Zyrës së Auditimit të Kosovës, gjegjësisht neni 3, paragrafi 2, parasheh që Auditori i Përgjithshëm në bazë vjetore kryen auditimin e të gjitha organizatave buxhetore duke përfshirë subjektet të cilat janë më shumë se 50% në pronësi publike

Një nga arsyetimet e dhëna për ndryshim/plotësim të ligjit është edhe mungesa e transparencës. Mirëpo, partitë në pushtet të cilat kanë shtyrë përpara ndryshim/plotësimet, vetë ato nuk i kanë bërë publike financat e partive të tyre

ose marrin mjete financiare nga Fondi i Konsoliduar i Kosovës. Mirëpo, askund në Ligjin për Themelimin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm dhe Zyrës së Auditimit të Kosovës nuk përmendet auditimi i partive politike. Jo të gjitha partitë politike financohen nga fondet publike. Sipas Ligjit nr.03/L-174 për financimin e subjekteve politike, Financimi publik i subjekteve

politike bëhet përmes Buxhetit të Republikës së Kosovës, nga Fondit për mbështetjen e subjekteve politike. Shuma e mjeteve buxhetore dedikuar Fondit për mbështetjen e subjekteve politike nuk mund të kalojë (0.17%) të Buxhetit të Kosovës. Për financimin

e aktiviteteve të rregullta të subjektit politik, mjetet nga Fondi për mbështetjen e subjekteve politike, ndahen në mes të subjekteve politike të përfaqësuara në Kuvend në bazë të numrit të ulëseve për atë mandat.

Pasi që Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) ka mandat të auditoj vetëm ato subjekte që financohen në masën 50% të

fondeve publike, pothuajse asnjë nga partitë nuk e plotëson këtë kusht. Në anën tjetër mbetet e paqartë nëse ZAP do të auditoj edhe burimet private të financimit të partive politike apo do të përqëndrohet vetëm në mënyrën e shpenzimit të fondit publik për subjektet politike? Andaj, krahas ndryshimeve në Ligjin për Financimin e Partive Politike duhet të bëhen ndryshime edhe në Ligjin për Themelimin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm dhe Zyrës së Auditimit të Kosovës.

Mirëpo, edhe ligji aktual garanton një proces transparent dhe të përgjegjshëm. Sipas paragrafit 3 të nenit 9, për të përfituar fondet nga Buxheti i Kosovës, subjektet politike duhet të dorëzojnë raportet financiare të vitit paraprak. Subjektet kanë vazhduar të marrin fondet publike edhe pa i përmbushur detyrimet e tyre për raportim. Problemi me Ligjin për Financimin e Subjekteve Politike nuk është përmbajtja e tij, por zbatimi i tij në praktikë.

Komisioni Evropian nuk i jep më rroga Agjencionit Kosovar të Privatizimit

Në mbledhjen e 28-të dhe 34-të të Qeverisë së Kosovës, të mbajtur më 2 dhe 25 gusht 2011, u miratuan dy propozime të Ministrisë së Financave për të ndarë mjete financiare prej 344 mijë euro (60,000 për korrik dhe 284,000 për gusht) për mbulimin e shpenzimeve për paga dhe mëditje për stafin e Agjencionit Kosovar të Privatizimit (AKP). Kjo shumë është e destinuar të shpenzohet për muajt korrik dhe gusht. Deri në qershor të këtij viti, mbulimin e shpenzimeve për paga dhe mëditje për stafin e AKP-së e ka bërë Komisioni Evropian në cilësinë e donatorit.

Çështja e rrogave dhe

mëditjeve për punëtorët e AKP-së pritet të rregullohet me ligj, i cili është miratuar nga Qeveria më 15 qershor të këtij viti. Tani, ky projektligj ka kaluar leximin e parë në Kuvend dhe pritet të miratohet në muajt në vazhdim.

Deri në qershor të këtij viti, mbulimin e shpenzimeve për paga dhe mëditje, për stafin e AKP-së, e ka bërë Komisioni Evropian, në cilësinë e donatorit

Një vendim i tillë, sipas Ministrisë së Financave, është dashur të merret për shkak të ndërprerjes së fondeve për këtë qëllim nga KE dhe si rezultat

është dashur të gjendej një zgjidhje e përkohshme deri në miratimin dhe hyrjen në fuqi të Ligjit për Agjencionin Kosovar të Privatizimit.

Edhe në tabelat buxhetore të Ligjit të Buxhetit për vitin 2011,

figuron shuma prej 805 mijë euro, për paga dhe mëditje, për 279 punonjësit e këtij institucioni.



Qeveria vazhdon me shpronësim të pronave të paluajtshme për Autostradën Vërmicë – Merdare

Në mbledhjen e 29-të, Qeveria e Republikës së Kosovës mori 2 vendime që kanë të bëjnë me shpronësim të tokave për autostradën Vërmicë – Merdare. Me vendimin 06/29, u miratua shpronësimi dhe kompensimi i pronarëve të pronave të

Vendimet e fundit të cilat u morën përkitazi me shpronësimin e parcelave private me qëllim krijimin e hapësirës së duhur për vazhdimin e kryerjes së punimeve në autostradë, i përkasin mbledhjes së 12-të, të mbajtur më 27 prill 2011,

Me vendimin e Qeverisë së Kosovës 04/124, të datës 13.5.2011, ishte miratuar kërkesa për shpronësimin e pronave të paluajtshme në këto dy rrugë M9 dhe M2 si dhe ngastrën kadastrale 7497 sipas fletës poseduese nr. 16590, zona kadastrale Prishtinë dhe rreth-rrotullimi.

Qeveria shpronëson pronat tek “segmenti 2” (Zhur-Prizren) dhe “segmenti 5” (Qafa e Dulës-Gjurgjicë)

paluajtshme në “segmentin 2”, Zhur-Prizren, ndërsa me vendimi 07/29, u miratua propozim-vendimi preliminar për shpronësimin e “segmentit 5”, Qafa e Dulës - Gjurgjicë, përkatësisht udhëkryqi në rrugën M9 të autostradës Vërmicë – Merdare.

përkatësisht, 3 vendimeve për segmentet 1, 2, 3 dhe 4.

Gjithashtu, në po të njejtën mbledhje, Qeveria mori vendim përfundimtar për shpronësimin e pronave të paluajtshme në rrugën M9, Fushë Kosovë – Arllat - Gjurgjicë dhe në rrugën M2, Prishtinë – Mitrovicë.

Realizimi këtyre projekteve ka filluar më herët mirëpo kompensimi i pronarëve përgjatë këtyre rrugëve nuk është kryer në mungesë të Ligjit për Shpronësim. Raportin për vendimin që i ka paraprirë këtij vendimi mund ta lexoni këtu: <http://www.gapmonitor.org/?id=2&n=27>

Miratohet Plani Zhvillimor Strategjik 2011-2013 i Ministrisë për Komunitete dhe Kthim

Në mbledhjen e 32 të radhës, të mbajtur më 10 gusht 2011, Qeveria e Kosovës miratoi Planin Zhvillimor Strategjik 2011 – 2013 të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim (MKK).

MKK ka për qëllim të siguroj që politikat në nivel qendror dhe lokal të përmbajnë dispozita për mbrojtjen e të drejtave për komunitete. Në të njëjtën kohë, ky projektligj ka për qëllim që të mbështesë punën dhe të ofroj udhëzime për ministritë tjera në procesin e hartimit të legjislacionit në mënyrë që të respektohen të drejtat e komuniteteve përfshirë dhe procesin e kthimit.

Sipas këtij Plani, synimet kryesore të MKK-së janë që të zbatohet legjislacionin për promovimin dhe mbrojtjen e Komuniteteve, përfshirë kthimin; të promovojë krijimin e kushteve për kthim; të zhvillojë politikat për dialog dhe ndërtim të besimit si dhe mbështetje të zbatimit të atyre aktiviteteve; të mbështesë zhvillimin dhe zbatimin e strategjive të Qeverisë për

Komunitete dhe Kthim.

Si prioritete strategjike MKK konsideron: krijimin e bazës ligjore për një shoqëri demokratike, rritjen e besueshmërisë dhe bashkëpunimit me institucionet vendore dhe ndërkombëtare; rolin e MKK-së në procesin e kthimit të komuniteteve; ngritjen e vetëdijes për nevojat më të mëdha për fonde për zhvillimin e komuniteteve (sigurimi i fondeve nga donatorët); stabilizimin e komuniteteve përmes

Monitorim të Projekteve; rritjen e kapacitetit për të planifikuar dhe menaxhuar burimet njerëzore në MKK, si dhe përmirësimin e menaxhimit të shërbimeve përkatëse.

Ministria për Komunitete dhe Kthim është themeluar më 24 janar 2005, duke u bazuar në Rregulloren e UNMIK-ut 2004/50 të datës 2 Dhjetor 2004. Deri në vitin 2006, komuniteti ndërkombëtarë ka bërë organizimin e procesit të kthimit, ku më pas kjo përgjegjësi

Sipas këtij plani, synimet kryesore të MKK-së janë zbatimi i legjislacionit për promovimin dhe mbrojtjen e komuniteteve

implementimit të projekteve të MKK-së dhe rritjen e numrit të kthimit të qëndrueshëm.

Përveç tjerash, Ministria gjithashtu do të adresojë hendekun aktual të kapaciteteve, të identifikuar në rishikimin funksional, duke krijuar Departamente të reja: Departamentin për Planifikim të Politikave dhe Analizave; Departamentin për Menaxhim dhe

ka kaluar në duar të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim.

Duke u bazuar në Strategjinë për Komunitete dhe Kthim 2009-2013, më pak se 20,000 persona nga komunitetet pakicë janë kthyer në Kosovë që nga konflikti i vitit 1999. Në Planin Zhvillimor Strategjik 2011-2013 nuk përfshihen të dhëna mbi procesin e kthimit si dhe nuk adresohen fare se kur do të përmbyllet ky proces.

Themelohet Bordi për Hartimin dhe Monitorimin e Strategjisë për Ri-integrimin e Personave të Riatdhesuar

Qeveria e Kosovës, në mbledhjen e saj të 33, miratoi vendimin për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit nr. 7/123 të datës 30.4.2010, për themelimin e Bordit për Hartimin dhe Monitorimin e Strategjisë për Ri-integrimin e Personave të Riatdhesuar.

Duke u bazuar në Strategjinë për Ri-integrimin e Personave të Riatdhesuar, detyrë e Bordit për monitorimin e kësaj Strategjie është që të siguroj implementimin efikas të strategjisë dhe planit

të veprimit për ri-integrimin e personave të riatdhesuar. Ky bord përbëhet prej ministrive si në vijim: MAPL, MPB, MPMS, MMPH, MASHT, MSh, MKK, MF dhe MIE, Organizatat ndërkombëtare si dhe akterët e tjerë relevant të shoqërisë civile.

Kryesues i këtij Bordi u emërua Ilhami Gashi, Sekeratë i Përgjithshëm i MPB-së, kurse zv.kryesues u emërua Besnik Osmani, Sekretar i Përgjithshëm i MAPL-së; ndërsa anëtarët e këtij Bordi u emëruan: Fitimi

Krasniqi, Sekretar i Përgjithshëm i ZKM-së; Xhavit Dakaj, Sekretar i Përgjithshëm i MASHT-së; Ilir Tolaj, Sekretar i Përgjithshëm i MSh-së; Eshref Shabani, Sekretar i Përgjithshëm i MPMS-së; Naim Baftiu, Sekretar i Përgjithshëm i MF-së; Zana Kotorri, Sekretare e Përgjithshme e MKK-së; Islam Caka, Drejtor i DShAM-it/MPB; Ruzhdi Halili Drejtor i ZPS-ZKM; Përfaqësues i Komisionit Evropian; Përfaqësues i UNHCR-it dhe Përfaqësues i IOM-it.

Bordi në bashkëpunim me sekretariatit e tij do të:

- përgatis planin e veprimit për implementim të strategjisë;
- dizajnoj dhe propozoj buxhetin për implementim të strategjisë;
- menaxhoj me fondin për ri-integrimin e personave të riatdhesuar,
- merr vendime për shpenzimet nga ky fond dhe do të bëjë monitorimin e shfrytëzimit të këtij fondi;
- caktoj zonat e përgjegjësisë për çdo ministri relevante, në nivelin qendror dhe në nivelin komunal për administratat e drejtorive dhe të komunave.
- mbikëqyrë dhe monitoroj implementimin e strategjisë;
- koordinoj punën e ministrive përgjegjëse;
- vendos mekanizmat efikas për shpërndarjen e informacioneve ndërmjet ministrive dhe komunave të përfshira;
- koordinoj me kuvendet relevante komunale implementimin e strategjisë në nivel të komunave;
- takohet në baza të rregullta kohore dhe do të informoj qeverinë për të arriturat dhe sfidat e evidentuara gjatë punës së tij, respektivisht gjatë monitorimit të zbatimit të strategjisë dhe planit të veprimit për ri-integrimin e personave të riatdhesuar;
- koordinoj aktivitetet e donatorëve/organizatave të cilat janë aktive në zbatimin e strategjisë dhe planit të veprimit.

Ky vendim lidhet ngushtë me procesin e zbatimit të kriterëve për marrjen e strategjisë për liberalizim të vizave, që sipas të gjitha gjasave, pas vizitës së një ekipi vlerësues nga Komisioni Europain që pritet t'i bëjë Kosovës këtë muaj, pritet të merret zyrtarisht nga Prishtina zyrtare.

Gjithashtu gjatë muajit gusht është aprovuar edhe vendimi për themelimin e Këshillit për Mbrojtjen dhe Drejtësinë për Fëmijë.

Detyrë e Këshillit do të jetë definimi i prioriteteve dhe masave të nevojshme që duhen ndërmarrë për përmirësimin e situatës së tanishme në lidhje me Mbrojtjen dhe Drejtësinë e Fëmijëve si dhe lehtësimin dhe monitorimin e implementimit të politikave, programeve dhe masave të tjera të aprovuara që kanë të bëjnë me Mbrojtjen dhe Drejtësinë për Fëmijë në nivel qendror dhe lokal.

Ky këshill do të përbëhet

nga këta përfaqësues: Drejtori i ZQM/ZKM, kryesues; dhe prej dy zv. Kryesuesëve: Drejtori i Departamentit IEKP/MD; Udhëheqësi i Divizionit të ShS/MPMS, si dhe prej 17 anëtarëve: Koordinatore NjDNj/MD; Koordinatore NjDNj/MPMS; Drejtori i Qendrës Korrektuese Lipjan/MD; Udhëheqësi i Divizionit MDA/MD; Zyrtar i Lartë Ligjor/MD; Udhëheqësi i i Divizionit Ligjor në ShKK/MD; Zyrtar Ligjor në Sekretariat/KGJK; Koordinatore e Programit?IGJK; Zyrtar nga Policia në Komunitetet/ PK; Zyrtar financiar nga DMS/MPMS; Koordinatore NjDNj/MAShT; Koordinator NjDNj/MF; Menaxhere e mbrojtjes të viktimave/MD; Zyrtare për Shëndetin e NF/MSh; Drejtor i Departamentit për IE/MPB; Udhëheqës i Divizionit për RPLA/MAPL; Drejtor Ekzekutiv/Oda e Avokatëve. Ndërsa në cilësinë e anëtarëve Këshilltar të Jashtëm do të jenë: një Zyrtar për Mbrojtjen e Fëmijëve/UNICEF

dhe një Zyrtar për Mbrojtjen e Fëmijëve DM/UNICEF. Si dhe në cilësinë e vëzhguesit do të jenë: Zyrtarë për të Drejtat e Fëmijëve/Ombduspersoni; Drejtori i Zyrës për Planifikim Strategjik/ZKM; Koalicioni për Mbrojtjen e Viktimave dhe Drejtori i TDH/OJQ.

Përderisa Zyra e Kryeministrit/ Zyra për Qeverisje të Mirë do të shërbejë si sekretariat për të koordinuar, monitoruar, zhvilluar dhe mirëmbajtur aktivitetet e nevojshme për punën e këtij këshilli.



Miratohet edhe projektligji i fundit nga Pakoja e Ahtisaarit

Më 10 gusht 2011, në mbledhjen e 32 të Qeverisë së Kosovës, u aprovua Projektligji për Hoçën e Madhe. Ky projektligj, ashtu sikurse edhe ai për Qendrën Historike të Prizrenit, janë hartuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Këto dy projektligje kanë shumë pak të bëjnë me mjedis dhe planifikim hapësinor, e më shumë me trashëgimi kulturore, historike dhe fetare dhe etnike.

Projektligji për Hoçën e Madhe është i fundit në listën e ligjeve të parapara me Pakon e Ahtisaarit. Hartimi i këtyre projektligjeve është mbajtur fshehtë nga publiku dhe nuk ka pasur diskutime publike për to.

Gjersa miratimi i tyre është shtyrë tri vite pas shpalljes së pavarësisë, për shkak se këto dy akte ligjore kanë ngjallur reagim të kundërt nga shumica e popullsisë. Miratimin e një ligji të veçant për Hoçën e Madhe e

ka kundërshtuar edhe Kryetari i Komunës së Rahovecit, komunë në të cilën bën pjesë fshati Hoçë e Madhe.

Sipas nenit 1 të Projektligjit për Hoçën e Madhe, “qëllimi i këtij ligji është mbrojtja dhe ruajtja e trashëgimisë fetare dhe kulturore e fshatit Hoçë e Madhe dhe promovimi i saj si fshat me vlera kulturore dhe fetare të rëndësishme lokale, shtetërore dhe ndërkombëtare si dhe me qëllim të zhvillimit të qëndrueshëm dhe të harmonizuar të tij.” Pas hyrjes


zgjidhen drejtpërdrejt nga fshati Hoçë e Madhe dhe një anëtar do të zgjidhet nga Kisha Ortodokse Serbe. Projektligji nuk përcakton nëse dy anëtarët e Komitetit që zgjidhen nga Kuvendi Komunal duhet apo jo të jenë pjesëtarë të komunitetit serb. Buxheti për themelimin dhe funksionimin e Komitetit ndahet në pajtim me Ligjin mbi Financat lokale, i cili i ofrohet Komunës si grant për kompetencat e shtuara.

Me Ligjin nr.03/L-040 për vetëqeverisje lokale parashihet

Deri më tani Qeveria ka përcjell në Kuvend dhe Kuvendi ka miratuar 51 ligje nga Pakoja e Ahtisaarit. Të gjitha këto janë aprovuar në procedurë të përsheptuar

së këtij ligji në fuqi, Kuvendi Komunal i Rahovecit duhet të themeloj Komitetin për Hoçën e Madhe. Ky komitet do të jetë i përhershëm dhe në përbërje të tij do të ketë pesë anëtar: dy anëtar nga Kuvendi Komunal i Rahovecit, dy anëtar do të

funksionimi i dy komiteteve të përhershme për çdo komunë: komiteti për buxhet dhe financa dhe komiteti për komunitete. Komiteti për Hoçën e Madhe e ngrit në tri numrin e komiteteve të përhershme, gjë që nuk parashihet me Ligjin për



Vetëqeverisje Lokale.

Komiteti ka autoritet që në bashkëpunim me komunën të vendos për Planin Zhvillimor Komunal. Gjithashtu, me anë të këtij dokumenti ligjor, ndalohen disa veprimtari të cilat mund të ndikojnë në ndryshimin e imazhit të lokalitetit. Këto ndalesa janë të parapara me nenin 8.

Me nenin 9 të Projektligji parashihet që për aktivitetet siç janë: ndërtimet apo zhvillimet komerciale të tilla si strukturat ose godinat më të larta se

automjeteve, supermarketeve, klubeve të natës, apo ndonjë ndërtimi tjetër në shkallë më të gjerë në zonat rurale, tubimet, argëtimi dhe zbavitja publike dhe urbanizimi i tokës bujqësore, organet kompetente të Komunës kërkojnë pajtimin e Kishës Ortodokse Serbe. Kisha Ortodokse Serbe duhet të përgjigjet brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të kërkesës për dhënien e pajtimit.

Projektligji për Hoçën e Madhe do t'i dërgohet Kuvendit

Projektligji për Qendrën Historike të Prizrenit dhe Projektligji për Hoçën e Madhe përmbyllin pakon e ligjeve të parapara me Dokumentin e Ahtisaarit

manastiri/kisha/monumenti kulturor që duhet të mbrohet; ndërtimi i rrugëve, ndërtimi i magazinave, punëtorive, shitoreve, restoranteve, bareve, kafeterive, hoteleve/moteleve, tezgave dhe kioskave ushqimore, stacioneve të furnizimit me karburant dhe riparimit të

të Kosovës për aprovim. Nëse Kuvendi ndjek procedurën e rregullt të shqyrtimit dhe aprovimit të projektligjeve, atëherë me këtë projektligj do të merret Komisioni Parlamentar për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor. Në rast se Kuvendi nuk aplikon procedurën

e rregullt, atëherë mund të krijohet një komitet ad-hoc për Ligjet e Pakos së Ahtisaarit dhe ky ligj, së bashku me Ligjin për Qendrën Historike të Prizrenit, do të aprovohen në procedurë të përshpejtuar.

Instituti GAP ka kundërshtuar aprovimin e ligjeve në procedurë të përshpejtuar, ngase të gjitha ligjet e aprovuara në këtë mënyrë janë dëshmuar si ligje të pazbatueshme, keq të shkruara, të cilat pastaj janë ri miratuar me ndryshime dhe plotësimi.

Kuvendi duhet të ndjek procedurën e rregullt të miratimit të ligjeve. Komisioni Parlamentar për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor duhet të organizojë dëgjime publike për Projektligjin për Hoçën e Madhe dhe propozimet e marra nga dëgjimet publike t'i inkorporojë në draftin final të Ligjit për Hoçën e Madhe.



Definohet kufiri ndarës i aseteve në mes të KEK-ut dhe KOSST-it

Në mbledhjen e 29 të Qeverisë së Kosovës, të mbajtur më 3 gusht 2011, u miratuar propozimi i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik (MZHE) për ndarjen e kufirit të pronës në mes të KEK-ut dhe KOSST-it.

Ky propozim-vendim nga MZHE erdhi si rezultat i procesit të privatizimit të njësisë së distribucionit në kuadër të KEK-ut, dhe ndihet nevoja e domosdoshme për të rregulluar edhe një problem sa i përket definimit të kufirit të aseteve në mes të KEK-ut dhe KOSST-it. Është fjala për asetet 400/220/110 kW duke përfshirë edhe transformatorët 220/35/10(20) kW dhe 110/

xkW si dhe fushat përkatëse me ndërprerësin e transformatorëve 35kW dhe 10(20) kW, pronësia e së cilave ka qenë e padefinuar deri më tani.

Në mbledhjen e komisionit ndërministror për ndërmarrjet publike, të mbajtur më 11 qershor 2010, KOSST-i

nga komisioni.

Në procesin e privatizimit të Kompanisë së Distribucionit dhe Furnizimit, dhe fillimit të partneritetit publiko-privat për zhvillimin e kapaciteteve të reja gjeneruese, transferimi i pronës së transformatorit 220/35/10(20) kW dhe 110/xkW në KOSST do të

Transferimi i pronës së transformatorit 220/35/10(20) kW dhe 110/kW në KOSST do të sigurojë funksionim më të mirë të tregut të energjisë, dhe poashtu, do të ketë monitorim dhe kontroll më efikas të operatorëve privat

kishte bërë kërkesë që pronësia e transformatorit prej 220/35/10(20) kW të hidhej në pronësinë e kësaj të fundit, kërkesë e cila ishte përkrahur

siguroj funksionim më të mirë të tregut të energjisë, dhe poashtu, do të ketë monitorim dhe kontroll më efikas të operatorëve privat.

Përcaktohet paga minimale në Republikën e Kosovës

Në mbledhjen e 33, të mbajtur më 18 gusht 2011, Qeveria e Republikës së Kosovës miratoi vendimin e Këshillit Ekonomiko - Social për përcaktimin e pagës minimale.

Bazuar në Ligjin për Këshillin Ekonomiko – Social dhe Ligjin e Punës, ky këshill është përcaktuar si autoriteti përfundimtar i përcaktimit të pagës minimale në Kosovë. Fillimisht në muajin prill 2011, KES kishte marr vendim që paga minimale për vitin 2011 të jetë 170 euro. Mirëpo me rekomandimet e Fondit Monetar Ndërkombëtar, në mbledhjen e 33-të Qeverisë, u vendos që paga minimale në Kosovë për të punësuarit e moshës 18 - 35 vjeç të jetë 130 euro, ndërsa për të punësuarit e moshës mbi 35-65 vjeç të jetë 170 euro.

Ligji për KES ishte miratuar

në gusht të vitit 2010, përmes së cilit përfundimisht rregullohet dhe përcaktohet mënyra e themelimit të KES, përcaktimi i detyrave, përgjegjësi dhe kompetencave të këtij organi si dhe nxitja e dialogut social në mes të partnerëve social. Për më tepër, ky projektligj përcakton edhe kriteret

punëdhënësve, dhe 5 anëtarë nga organizatat e punëtorëve. Ky këshill kryesohet nga Ministri i MAPL-së.

Kjo është hera e dytë që përcaktohet paga minimale në Kosovë. Në vitin 2005 Këshilli Konsultativ Trepalësh, paraardhësi i Këshillit Ekonomiko Social, kishte

Në konsultim të ngushtë me FMN-në, Këshilli Ekonomiko-Social vendosi që paga minimale të jetë 130 euro (18 - 35 vjet), gjegjësisht 170 euro (35 - 65 vjet)

për përfaqësimin e organizatave të punëmarrësve dhe punëdhënësve në KES, si organ i pavarur dhe apolitik, i cili do të udhëheq në nivel nacional konsultimet për çështjet si marrëdhënia e punës, çështjet sociale dhe ato politiko-ekonomike.

KES ka në përbërje të tij 15 anëtarë: 5 nga Qeveria (5 ministri), 5 anëtarë janë organizatat e

përcaktuar pagën minimale për atë vit. Në 2005, paga minimale ishte përcaktuar të jetë 120 Euro. Siç dihet, Kontrata e Përgjithshme Kolektive dhe Aneksi i saj nuk janë zbatuar asnjëherë. Me hyrjen në fuqi të Ligjit të Punës, Këshilli Ekonomiko-Social duhet të mbledhet dhe të përcaktojë pagën minimale.

Ministria e Infrastrukturës kompenson mjetet financiare për shërbimet e transportit humanitar për banorët e Kodrës së Minatorëve në Mitrovicë

Në mbledhjen e 33-të të Qeverisë, të mbajtur më 17 Gusht 2011 është miratuar propozimi i Ministrisë së Infrastrukturës për kompensim të mjeteve financiare për shërbimet e transportit humanitar për banorët e Kodrës së Minatorëve në Mitrovicë.

Transporti me autobus humanitar prej pjesës jugore të Mitrovicës deri në lagjen e Minatorëve për vitet 2007-2010

është bërë nga një kompani autobusësh nga Zubin Potoku me rekomandim të komunës së Mitrovicës. Shërbimet e transportit kësaj kompanie prej vitit 2003 deri 2005 ia ka paguar UNMIK-u, kurse për vitet 2005-2007 pagesa është bërë nga Ministria për Komunitete dhe Kthim (MKK). Ndërkaq për periudhën 2007-2010 kësaj kompanie nuk i është bërë asnjë pagesë megjithëse shërbimet kanë vazhduar të kryhen. Pas kërkesës

së kompanisë për pagesë të shërbimeve gjatë këtyre viteve është formuar një komision për shqyrtim që ka vërtetuar kryerjen e shërbimeve dhe ka caktuar vlerën e borxhit prej 89,700 Euro që i duhen paguar kësaj kompanie, shumë kjo që është marrë përsipër të paguhet nga Ministria e Infrastrukturës (MI), gjegjësisht nga Fondi për Transport Humanitar.

PTK ndan edhe 15 milionë euro për buxhet

Në mbledhjen e 34 të Qeverisë së Kosovës, të mbajtur më 25 gusht 2011, u marr vendimi për marrjen e 15 milionë eurove dividendë nga PTK-ja.

Vendimi u marr duke u bazuar në Ligjin për Ndërmarrjet Publike, përkatësisht nenin 3 dhe 5 si dhe në konsultim me menaxhmentin

dhe bordin e kësaj kompanie.

Vlera e kësaj shume financiare konsiderohet e një rëndësie të veçant duke marrë parasysh faktin që qeveria e Kosovës është duke u ballafaquar me krizë buxhetore të shkaktuar si rezultat i ndërprerjes së marrëveshjes me FMN-në.

Kjo është hera e dytë brenda këtij viti që ndërmarrja më e madhe publike në vend, PTK ndan mjete financiare për buxhetin e Kosovës. Në mbledhjen e mbajtur në muajin mars, Qeveria kishte marr 40 milionë euro dividendë nga PTK-ja.

Miratohet Planin Strategjik për Arsimin e Kosovës 2011-2016

Qeveria e Kosovës, në mbledhjen e saj të 34, të mbajtur më 25 gusht 2011, miratoi Planin Strategjik për Arsimin e Kosovës 2011 -2016 (PSAK). PSAK është një plan pesëvjeçar që lidhë arsimin gjatë gjithë jetës me gjithëpërfshirjen në arsim dhe një model i të nxënies për të arritur tek të gjithë nxënësit, si dhe ofron mundësi të barabarta për arsimim cilësor për të gjithë. Gjithashtu ky është një plan kyç për investime në sektorin e

arsimit. Sipas këtij plani, MASHT do të zhvillojë një plan vjetor të implementimit, i cili do të jetë

kësaj, MASHT do të krijojë edhe mekanizma për rishikimin e rregullt të performancës

Një ndër prioritet kyçe të këtij plani është edhe zvogëlimi i numrit të ndërrimeve në shkolla, reduktimi i ndërrimeve të dyfishta, kryesisht në zonat urbane, përmes ndërtimit të shkollave të reja fillore e të mesme

një hap vendimtar për sigurimin e përkrahjes së vazhdueshme për sektorin e arsimit. Pos

së sektorit, përfshirë edhe ndikimin e vendimeve kryesore investuese.

Prioritetet dhe çështjet strategjike që trajtohen nga PSAK, përfshijnë:

- Zhvillimin dhe përkrahjen e një sistemi gjithëpërfshirës arsimor që siguron qasje të barabartë në arsimim cilësor;
- Zvogëlimin e numrit të ndërrimeve në shkolla, reduktimi i ndërrimeve të dyfishta, kryesisht në zonat urbane, përmes ndërtimit të shkollave të reja fillore e të mesme;
- Zhvillimin e ambienteve miqësore shkollore për fëmijët;
- Zhvillimin dhe përkrahjen e shërbimeve të zhvillimit në fëmijërinë e hershme; Zhvillimin dhe zgjerimin e shkollimit të mesëm të lartë;
- Përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies e të nxënies dhe promovimin e rezultateve cilësore të të nxënies duke definuar dhe ndihmuar nxënësit që të mësojnë atë që duhet të mësojnë dhe përkrahja e të nxënies për të nxënë;
- Ristrukturimin e arsimit të mesëm dhe afirmimin e arsimit e aftësimin të mesëm profesional;
- Zhvillimin e Qendrave të Kompetencës;
- Përshtatjen më të mirë të arsimit dhe punësimin, përfshirë edhe zhvillimin e arsimit dhe aftësimin të lartë profesional si përgjigje ndaj kërkesave të tregut të punës;
- Përmirësimin e cilësisë së arsimit të lartë duke siguruar kontrollin e cilësisë, aplikimin e standardeve evropiane dhe shqyrtimin e organizimit të strukturave akademike;
- Zgjerimin e spektrit e të shërbimeve të arsimit të lartë dhe themelimin e universiteteve të reja;
- Themelimin e institucioneve hulumtuese brenda institucioneve të arsimit të lartëpërmendur, ofrimin e shërbimeve për sektorin privat dhe për qëllime të tjera;
- Zhvillimin e Teknologjisë së Informimit e të Komunikimit (TIK) në të gjitha nivelet dhe segmentet e arsimit;
- Përcaktimin e zhvillimit të resurseve njerëzore si një prioritet kombëtar dhe krijimin e një kulture të mësimin gjatë gjithë jetës

Secili program nënsektorial i përmbahet një strukture të kornizës logjike dhe për secilin prioritet janë hartuar caqet, objektivat, aktivitetet dhe treguesit.

Për gjashtë vitet e ardhshme 2011 – 2016 kostoja e përgjithshme zhvillimore dhe kostoja shtesë operative do të jetë rreth 480 milionë euro. Kostoja e përgjithshme zhvillimore do

të arrij vlerën prej 242 milionë euro, ndërsa kostoja shtesë operative prej 238 milionë euro gjatë gjashtë viteve të zbatimit të PSAK-së.

PSAK është ndarë në tetë fusha programore për të cilat janë zhvilluar rezultatet dhe treguesit specifik. Këto tetë fusha programore janë dhënë në vijim:

- Edukimi parashkollor (EPSH) dhe Edukimi parafillor (EPF)
- Arsimi parauniversitar (APU)
- Arsimi dhe aftësimi profesional (AAP)
- Arsimi i lartë (AL)
- Zhvillimi profesional i mësimdhënësve (ZhPM)
- Arsimi dhe aftësimi i të rriturve (AARr)
- Teknologjia e informimit dhe e komunikimit (TIK)
- Ndërtimi i kapaciteteve (NK).

Më shpejtë, më lehtë:
GAP MONITOR
n'internet



www.gapmonitor.org



Ndërmarrësia dhe profesionet e së ardhmes në Kosovë

**Jeton Mehmeti
& Rudina Heroi**

Kosova ka dhe popullsinë më të re në Europë – 70% janë më të rinj se 35 vjeç, dhe shkallën më të lartë të papunësisë në mesin e të rinjve në Europë – 40% të numrit total të të papunëve. Në vitin 2008 Banka Botërore ka parashikuar se në pesë vitet e ardhshme edhe 200,000 të rinj do t'i bashkëngjiten fuqisë punëtore të Kosovës.

Nga ana tjetër, Kosova gjeneron shumë pak vende pune dhe për rrjedhojë, konkurrenca për ato vende pune është e ashpër. Faktorë me rëndësi që ndikojnë në garën e kërkimit për punë janë, pa dyshim, niveli i arsimit, shkathtësitë specifike për punë specifike si dhe vetë profesioni. Në dhjetë vitet e fundit, trendi i drejtimeve që të rinjtë kanë zgjedhur të studiojnë dhe profesionet që kanë zgjedhur të ndjekin e kanë ndryshuar fokusin në mënyrë të konsiderueshme.

Vite më parë, Fakulteti i Mjekësisë dhe Fakulteti i Shkencave Teknike kryesonin listën e kërkuar nga studentët. Në vitin 2011, lista kryesohet nga Fakulteti Ekonomik, Fakulteti Juridik apo Fakulteti i Edukimit. Në 2010, Fakulteti Ekonomik i Universitetit të Prishtinës kishte rreth 7000 studentë.

Ngjajshëm, profesionet që dikur kërkoheshin në treg sot konsiderohen më pak atraktive nga të rinjtë. Menaxhimi i biznesit, e drejta, mjekësia janë tani më tërheqëse për të rinjtë që kërkojnë punë se sa, le të themi, karriera në inxhinieri elektrike apo mekanike.

Në vende me shkallë të lartë të papunësisë si Kosova, krijimi i një vendi pune kundrejt gjetjes së një vendi pune është kyç për zhvillim ekonomik. Kosova ka nevojë për ndërmarrës të rinj kreativë dhe novatorë për të forcuar sektorin

e saj privat përmes produkteve dhe shërbimeve të reja. Kjo do të ndikojë pozitivisht edhe për zbritje të papunësisë, duke vepruar kështu si katalizator për zhvillim ekonomik dhe shoqëror.

Në të gjithë botën, kriza globale financiare e viteve 2008/2009 rezultoi në rritje të shkallës së papunësisë. Për shembull, në Europën Lindore, papunësia e të rinjve arriti në 25%. Meqë papunësia në mesin e të rinjve në Kosovë është edhe më sfiduese, të rinjtë duhet të eksplorojnë mundësi alternative për punësim, si ndërmarrësia, ose të jenë të hapur ndaj mundësive në profesione që do të jenë e ardhmja e zhvillimit ekonomik të Kosovës.

Ku do të jenë mundësitë për punësim dhe ndërmarrësi në të ardhmen e afërt në Kosovë? Këto mundësi, sigurisht që do të jenë në përputhje me kërkesën e ndryshueshme të tregut të punës dhe biznesit në Kosovë. Më poshtë është një listë e sektorëve kryesorë dhe shkathtësive specifike që do të kërkohen gjithnjë e më shumë.

Industria e përpunimit të drurit. Këto janë kompani që prodhojnë mobilje, dyer dhe dritare. Rezultatet e hulumtimeve tregojnë se gjashtë kompani vendore të përpunimit të drurit në Kosovë kanë një qarkullim vjetor prej €1-6 milionë, që nënkupton se ky është një biznes shumë fitimprurës. Këto kompani janë shumë të suksesshme, sin ë tregun vendor, ashtu dhe atë të eksportit. Mirëpo, ato kanë mungesa, për shembull të stafit të trajnuar se sit ë përdorin materialet bruto. Për rrjedhojë, kompanitë e përpunimit të drurit janë të detyruara të blejnë material të përpunuar, që shkakton shpenzime shtesë. Përveç kësaj, këto kompani po e gjejnë gjithnjë e më

'Shumica e vendeve të punës nuk do të vinë nga punëdhënësit tonë më të mëdhenj. Ato do të vinë nga më të vegjlit. Ne duhet të bëjmë çfarëdo që mundemi për ta bërë ëndrrën e ndërmarrësisë realitet'

- Ross Perot

të vështirë të punësojnë menaxherë kompetentë të prodhimit që do të bënin më të lehtë zgjerimin e tregut të tyre, apo dizajnerë për mobilje që do të bënin dizajne autentike dhe moderne për mobilje duke rritur kështu konkurrueshmërinë e mobiljeve të Kosovës në tregun rajonal dhe atë europian.

Teknologji Informative (TI). TI është një nga industritë më të fuqishme në botë, që ka lulëzuar falë zhvillimit të shpejtë të sektorit të kompjuterave dhe pajisjeve të tjera softuerike. Ky sektori kryesisht është në duar të të rinjve. Prandaj, Kosova ka një potencial unik për ta zhvilluar këtë sektor dhe më tej. Profesionistët e TI-së punojnë në disa lëmi, si e-qeverisja për qytetarët; dizajnimi i softuerëve kompjuterikë për qeverinë, institucionet, universitetet, kompanitë private, bankat, kompanitë e sigurimit; dizajn dhe mirëmbajtje të uebfaqeve, komunikim mes njerëzve etj. The Nevoja për ekspertë të TI-së në Kosovë pritet të rritet për shkak të reformave teknologjike që Kosova do të duhet të ndërmarrë si rezultat i numrit në rritje të kompanive vendore. Kjo është një mundësi e mirë për ndërmarrësi, pasi ekspertët e TI-së mund të ofrojnë gjithnjë e-shërbime përmes kompanive të tyre.

Agrobiznesi. Ky është tashmë një aktivitet fitimprurës për shumë familje kosovare, sidomos në zonat rurale ku papunësia është më e theksuar. Mundësitë për të punuar në agrobiznes po rriten krahas rritjes së kërkesës për produkte të freskëta vendore, si produkte të mishit apo qumështit. Ferma të vogla me lopë që shesin qumësht ose rrisin lopë për mish, ferma të pulave për vezë, qendra të grumbullimit dhe përpunimit të qumështit për jugort, ajkë etj., kanë potencial të mirë për

të qenë të suksesshme. Bletaria, kultivimi dhe përpunimi i frutave dhe perimeve, grumbullimi i frutave të pyllit janë të tjera ide për biznes me potencial, përmes të cilave shumë familje mund të rrisin të ardhurat e tyre vjetore.

Punë teknike. Në Kosovë po rritet shumë nevoja për saldues dhe molerë të certifikuar. Të rinjtë nuk kanë interes në profesione të tilla, por lajmi i mirë është se kompanitë vendore dhe ndërkombëtare që punojnë në vendin tonë do të kenë nevojë për më shumë njerëz me shkathtësi të certifikuara, si saldues apo molerë të certifikuar. Po ashtu, të tjera profesione për t'u marrë në konsideratë dhe që kërkojnë arsimim të lartë janë sociologët, psikologët, hulumtuesit, përpunuesit e të dhënave dhe statisticienët.

Është e vështirë të parashihet me saktësi se cilat profesione do të jenë më të kërkuarat në tregun e Kosovës. Mirëpo trendet aktuale sugjerojnë se nuk është shumë fitimprurëse, as për individin, as për shoqërinë në përgjithësi që disa fakultete të universitetit të kenë numra në masë të studentëve, ndërkohë që disa të tjerë konsiderohen më pak tërheqës, pavarësisht rëndësisë së asaj që ato mësojnë. Përveç kësaj, të rinjtë duhet të shqyrtojnë se cilat mund të jenë profesionet më të kërkuara pasi të kryejnë studimet, pavarësisht se cilat kanë profesionet më të kërkuara kur ata filluan të studiojnë. Studentët aktualë dhe një grup i atyre që kanë diplomuar duhet të marrin parasysh mundësinë e ndërmarrësisë si mënyrë punësimi. Ndërmarrësia mund të shërbejë si një hap shumë i rëndësishëm drejt përdorimit në praktikë të njohurive të tyre, dhe pse jo, drejt ndërtimit të një karriere të suksesshme.

Ky shkrim është publikuar për herë të parë në uebfaqen e Programit të USAID për Ndërmarrësit e Rinjë

5. Vendimet nga Mbledhja e 33 e Qeverisë së Kosovës, mbajtur me 17 gusht 2011:
 - 5.1 Vendimi 02/33, miratohet, me vërejtje, Projektligji për Qeverinë e Republikës së Kosovës;
 - 5.2 Vendimi 03/33, miratohet me vërejtje Projektligji për Agjencinë e Kosovës Mbrojtjen nga Rrezatimi dhe Siguria Bërthamore;
 - 5.3 Vendimi 04/33, miratohet propozim - vendimi i Këshillit Ekonomiko - Social për përcaktimin e pagës minimale;
 - 5.4 Vendimi 05/33, miratohet vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit nr. 7/123 të datës 30.4.2010, për themelimin e Bordit për Hartimin dhe Monitorimin e Strategjisë për Personat e Ri-atdhesuar;
 - 5.5 Vendimi 06/33, miratohet propozim-vendimi për kompensim financiar për shërbime të transportit humanitar për banorët e Kodrës së Minatorëve në Mitrovicë.
 - 5.6 Vendimi 07/33, Qeveria e Kosovës për anëtarë të Bordit të Pavarur për Miniera dhe Minerale propozoi: Naim Hyseni dhe Remzi Krasniqi;

6. Vendimet nga Mbledhja e 34 e Qeverisë së Kosovës, mbajtur me 25 gusht 2011:
 - 6.1 Vendimi 02/34, Miratohet Projektligji për të Huajt;
 - 6.2 Vendimi 03/34, Miratohet Projektligji për Shërbime Këshilluese për Bujqësi dhe Zhvillim Rural;
 - 6.3 Vendimi 04/34, Miratohet Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2003/24 për Sport;
 - 6.4 Vendimi 05/34, Miratohet Projekt-rregullorja e Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës;
 - 6.5 Vendimi 06/34, Ndryshohet dhe plotësohet vendimi nr. 03/13 i datës 29.04.2011;
 - 6.6 Vendimi 07/34, Autorizohet dhe urdhërohet të veprojë në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, si aksionar i vetëm në PTK, dhe ndërmarrë të gjitha masat e ligjshme, të nevojshme dhe të përshtatshme të aksionarit për realizimin e veprimeve ku PTK-ja dhe Bordi i Drejtorëve menjëherë të deklarojnë dhe paguajnë dividendë për aksionarin në shumën prej 15.000.000 euro;
 - 6.7 Vendimi 08/34, Miratohet Strategjia e Arsimit për periudhën 2011-2016;
 - 6.8 Vendimi 09/34, Miratohet Programi i Kosovës kundër Dhunës në Familje dhe Plani i Veprimit 2011-2014;
 - 6.9 Vendimi 10/34, Themelohet Këshilli për Mbrojtjen dhe Drejtësinë për Fëmijë;
 - 6.10 Vendimii 11/34, Miratohet Strategjia për Shëndetin e Nënës, Fëmijes, Adoleshentit dhe Shëndetin Riprodhues;
 - 6.11 Vendimi 12/34, Ndahen mjete financiare në vlerë prej 284 mijë euro për Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

gusht 2011

gap | monitor

i vendimeve të Qeverisë së Kosovës

GAP Monitor është publikim i përmuajshëm monitorues i vendimeve të Qeverisë i përgatitur nga Instituti për Studime të Avancuara GAP. Në këtë numër kanë kontribuar Agron Demi, agron@institutigap.org; Rudina Heroi, rudina@institutigap.org; Antigona Berisha, antigona@institutigap.org; Ilir Bajraktari dhe Kreshnik Berisha.

GAP Monitor botohet në kuadër të projektit të Monitorimit të Qeverisë, në kuadër të të cilit është krijuar edhe faqja e internetit www.gapmonitor.org, ku mund të gjenden të gjitha raportet monitoruese të vendimeve të Qeverisë pak ditë pas marrjes së vendimeve.

INSTITUTI PËR STUDIME TË AVANCUARA



Instituti GAP është Think Tank kosovar, që punon në ngushtimin e hendekut në mes qeverisjes dhe qytetarëve të Kosovës, në shërbim të avancimit të shoqërisë kosovare.

Rr. Nëna Terezë 41/29, 10000 Prishtinë, Kosovë | +381 38 224 145
monitor@institutigap.org | www.gapmonitor.org | www.institutigap.org

Instituti GAP përkrahet nga:



Opinionet e shprehura në këtë dokument janë ato të Institutit GAP dhe jo medoemos reflektojnë pikëpamjet e donatorëve të këtij projekti.